U narednom periodu, uz pomoć Osnivača I uz punu posvećenost naših kadrovskih kapaciteta, radićemo na poboljšanju uslova za korisnike naših usluga, kao I unapređenju rada Društva. Prošle godine smo u što većoj mjeri ispunjavali obaveze prema drugim licima, I dostigli veći nivo naplate usluga ovog Društva. Na kraju treba napomenuti da će Društvo preduzeti neophodne korake u svom daljem poslovanju, što će rezultirati većom stabilnošću u poslovanju ovog preduzeća.

Broj: ____/26-1

U Tuzima, 19.02.2026. godine

V.D. IZVRŠNOG DIREKTORA
Ruzhdi Lluca

Dostaviti:

- Službi Predsjednika opštine
- Sekretarijat za razvoj I projekte
- Arhivi Odbora direktora
- a/a



ShPK “PIJACE / TREGU” TUZ

R A P O R T I

**mbi realizimin e Programit të kryerjes së veprimtarive komunale
për vitin 2025**

Tuz, shkurt 2026

PËRMBAJTJA

I	Hyrje
II	Të dhënat themelore mbi ushtruesin e veprimtarive komunale - Të dhënat themelore identifikuese - Forma e organizimit - Aktet themeluese - Çështjet juridike - statusore - Struktura e pronësore - Organizimi i brendshëm dhe skema organizative - Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit së veprimtarive komunale - Organet e udhëheqjes dhe drejtimit
III	Kapacitetet e ushtruesit të veprimtarive komunale - Resurset njerëzore - Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale - Pajisjet dhe parku i makinave
IV	Bazat për përpilimin e Raportit
V	Raporti mbi realizimin e aktivitetit fizik
VI	Realizimi i planit financiar
VII	Politika e rrogave dhe punësimit
VIII	Borxhi
IX	Realizimi i planit të prokurimit public
X	Politika e çmimeve
XI	Vërejtjet përfundimtare

I HYRJE

Procedura e miratimit të raportit vjetor për realizimin e programit të kryerjes së veprimtarive komunale është e përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19, 140/22,84/24). Sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit të lartpërmendur, është përcaktuar që subjekti që kryen veprimtari komunale është i detyruar të dorëzojë raportin vjetor për realizimin e programit, së bashku me bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e suksesit, organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes lokale, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraprak. Gjithashtu, Kuvendi i njësisë së vetëqeverisjes lokale është i detyruar të miratojë raportin vjetor nga paragrafi 3 i këtij neni, më së voni deri më 30 qershor të vitit aktual për vitin paraprak.

Raporti vjetor për realizimin e programit të kryerjes së veprimtarive komunale (në tekstin e mëtejme: Raporti) i Shoqërisë për vitin 2025 është hartuar bazuar në dispozitat e Rregullores mbi përmbajtjen më të detajuar të programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për realizimin e programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 54/20), e cila është miratuar në përputhje me Ligjin për veprimtaritë komunale ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19,140/22,84/24).

Raporti përfshin të dhëna mbi funksionimin e Shoqërisë gjatë vitit 2025, duke përfshirë informacion mbi Shoqërinë dhe veprimtarinë e saj, kapacitetet e saj, realizimin e programit vjetor përmes treguesve fizikë dhe financiarë, politikën e pagave dhe punësimit, nivelin e borxhit, realizimin e planit të prokurimeve publike, politikën e çmimeve, si dhe vlerësimin e gjendjes dhe rezultateve të arritura.

Veprimtaria komunale e mirëmbajtjes së tregjeve, si dhe funksionimi i përgjithshëm i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz gjatë vitit 2025, është realizuar në përputhje me aktet ligjore themelore të Malit të Zi dhe aktet përkatëse të komunës së Tuzit:

Ligjet themelore

- Ligji mbi shoqëritë afariste ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 65/20, 146/21, 04/24,91/25, 121/25);
- Ligji mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19, 140/22, 85/25);
- Ligji mbi punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 08/21, 59/21, 68/21, 145/21, 77/24, 84/24, 86/24, 122/25);
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22, 81/25, 98/25);
- Ligji mbi prokurimin publik ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 03/23, 11/23, 84/24);
- Ligji mbi qasje të lirë në informacione ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 44/12, 30/17, 66/25);
- Ligji mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 34/14, 44/18, 84/24);

- Ligji mbi pagat e punonjësve të sektorit publik (“Fleta zyrtare e MZ”, nr. 16/16, 83/16, 21/17, 42/17, 12/18, 39/18, 42/18, 34/19, 130/21, 146/21, 92/22, 152/22, 152/22, 113/23, 48/24,84/24);
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorit (“Fleta zyrtare e MZ”, nr. 02/14, 06/14, 43/15, 70/17, 67/19, 146/21, 84/24);
- Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve (“Fleta zyrtare e MZ”, nr. 47/08, 04/11, 22/17, 123/24);
- Ligji mbi pronën shtetërore (“Fleta zyrtare e MZ”, nr. 21/09, 40/11, 23/25);
- Ligji për fiskalizimin në qarkullimin e produkteve dhe shërbimeve (“Fleta zyrtare e MZ”, nr. 46/19, 73/19, 08/21);
- Ligji për tregtinë e brendshme (“Fleta zyrtare e MZ”, nr. 49/08, 40/11, 38/19, 84/24).

Rregulloret e vetëqeverisjes lokale të Tuzit

- Vendimi mbi rëndin komunal të Komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 33/19);
- Vendimi mbi tregje (“Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 33/19, 62/22);
- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Pijace/Tregu” Tuz (“Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21);
- Statuti i SHPK “Pijace/Tregu” Tuz mbi të cilin Kuvendi Komunal i Tuzit dha pelqimin nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 (“Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 46/21);
- Kontrata mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale si dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit, (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023), si dhe Aneksi i parë i Kontratës në fjalë (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

II TË DHËNAT THEMELORE MBI USHTRUESIN E VEPRIMTARISË KOMUNALE

Në këtë pjesë të Raportit paraqesim të dhënat dhe informacionet kryesore mbi Sh.P.K. „Pijace/Tregu“ Tuzi, si subjekt që kryen veprimtarinë komunale të mirëmbajtjes së objekteve të tregjeve.

II/1 Të dhënat themelore identifikuese

Ushtuesi i veprimtarisë komunale është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. Numri amë i Shoqërisë është 03399109.

Themeluesi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz është Kuvendi i Komunës së Tuzit, numri amë 02628988 me seli në Tuz.

II/2 Forma e organizimit

Kuvendi i Komunës së Tuzit ka sjell Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar.

II/3 Aktet themeluese

Aktet themeluese të Shoqërisë janë Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021), Statuti i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021, mbi të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit dha pelqimin me Vendim nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21) si dhe Kontrata mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale si dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023). Duhet cekur se Kontrata në fjalë është ndryshuar me anë të Aneksit (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

II/4 Çështjet juridike - statusore

Statusi juridik i Shoqërisë është rregulluar me aktin themelues, përkatësisht me Vendimin për themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuzi, nr. 02-030/21-14528, prej më 24.11.2021 ("Fleta Zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21, prej më 03.12.2021), me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuzi, nr. 08-032/21-14776, prej më 01.12.2021, si dhe me Kontratën për besimin e kryerjes së veprimtarive komunale, së bashku me Aneksin e parë të saj.

II/5 Struktura pronësore

Statusi juridik i Shoqërisë rregullohet me aktin themelues, d.m.th. me **Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz** numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021), **Statut të SHPK „Pijace/Tregu“ Tuz** numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021 si dhe me **Kontratë mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale si dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit**, (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023). Duhet cekur se Kontrata në fjalë është ndryshuar me anë të **Aneksit** (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pijace/Tregu” Tuz është themelua nga ana e Kuvendit të Komunës së Tuzit me Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe dhe si e tillë është në pronësi të Komunës së Tuzit.

II/6 Ogranizimi i brendshëm dhe skema organizative

Në pajtim me Rregulloren aktuale mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (nr. 576/24-1 prej më 15.03.2024.) format bazë të organizimit të Shoqërisë janë sektoret, dhe ato janë:

- **Spektori për çështje teknike - operative dhe**
- **Spektori për çështje ekonomiko - juridike.**
- Në kuadër të Sektorit për çështje tekniko - operative funksionon Shërbimiu i çështjeve të tregut i cili ka në përbërjen e tij dy (2) reparte - **reparti i tregut të gjelbër** si dhe **reparti i mallrave të përzier**.

Ndërsa në kuadër të Sektorit për çështje ekonomiko - juridike funksionojnë dy shërbime **shërbimi i financave** dhe **shërbimi për çështje juridike dhe të përgjithshme**

II/7 Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit së veprimtarive komunale

Veprimtaritë themelore dhe dytësore që kryen Shoqëria dhe për të cilat është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Ekonomike janë të përcaktuara me Vendimin për themelimin, Statutin e Shoqërisë, si dhe me Kontratën për besimin e kryerjes së veprimtarive komunale (së bashku me Aneksin e parë), të lidhur me Komunën e Tuzit si Themelues.

Statuti i Shoqërisë përcakton veprimtarinë bazë që kryen Shoqëria, e cila është me interes publik dhe është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste me kodin 8299:

- ndërton, mirëmban dhe menaxhon objektet e tregut;
- ruan higjienën e përgjithshme në zonën e tregut dhe objektet tjera në pronësi të komunës së Tuzit;
- kryen punë të tjera në interesin publik.

Krahas këtyre aktiviteteve, Shoqëria kryen edhe veprimtari që nuk kanë karakter të aktiviteteve me interes publik, përkatësisht:

- përgatit dhe zbaton programe në fushën e investimeve;
- investimi në ndërtimin e objekteve me investim të përbashkët me investitorë të tjerë;
- marrja me qira e pasurive të paluajtshme dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme.

II/8 Organet e udhëheqjes dhe drejtimit

Shoqërinë e udhëheq Themeluesi në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë në bazë të Statutit të Shoqërisë, me ç'gjë sigurohet interesi publik.

Kuvendi i Komunës së Tuzit, si Themelues:

- miraton aktin e themelimit, ndryshimet dhe plotësimet e aktit të themelimit të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për Statutin e Shoqërisë;
- shqyrton raportin mbi punën dhe sjell Vendimin mbi shpërndarjen e profitit;
- emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordi të drejtorëve;
- sjell vendimin mbi ndryshimin e formës, ristrukturimin dhe likuidimin vullnetar të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për ndryshimin e emërimit, veprimtarisë, selisë dhe kapitalit themelor të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për çmimorën e shërbimeve, të cilën e përcakton Bordi i drejtorëve;
- kryen veprime të tjera në pajtim me ligjin, Vendimin mbi themelimin dhe Statutin.

Organe e Shoqërisë janë Bordi i drejtorëve si organ i drejtimit dhe Drejtori ekzekutiv si organ i udhëheqjes i Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve:

- drejton Shoqërinë dhe jep udhëzime drejtorit ekzekutiv në aspektin e udhëheqjes së punëve të Shoqërisë;
- sjell Stautin e Shoqërisë, me pajtim të themeluesit;
- emëron drejtorin ekzekutiv;
- i propozon themeluesit ndryshimin e kapitalit themelues;
- përcakton politikën afariste të Shoqërisë dhe sjell akte për zbatimin e saj në pajtim me udëzimet e themeluesit;
- kryen mbikëqyrjen e udhëheqjes së Shoqërisë;
- sjell planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit miratimin e raportit vjetor mbi realizimin e planit vjetor të punës si dëshmisë financiare;
- përcakton çmimoren për kryerjen e shërbimeve të Shoqërisë, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit shpërndarjen e fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;
- sjell aktin mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në pajtim me Kryetarin e Komunës;
- përcakton politikat e kontabilitetit të Shoqërisë dhe politikës së menaxhimit të rizikut;
- jep dhe shkarkon prokurën;
- miraton raportet tremujore të drejtorit ekzekutiv mbi veprimtarinë e Shoqërisë;
- sjell Rregulloren e procedurave mbi punën e Bordit të drejtorëve;
- kryen detyra tjera në pajtim me ligjin dhe Statusin e Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve përbëhet nga pesë (5) anëtarë, që janë përfaqësuesit e Themeluesit.

- Sa i përket punës së Bordit të drejtorëve, në vitin 2025 janë mbajtur gjithsej 10 seanca. Ndër të tjera, në senacat e Bordit të drejtorëve janë sjellur dhe miratuar aktet e nevojshme për funksionimin e Shoqërisë.

Drejtori ekzekutiv, si organ i udhëheqjes së Shoqërisë kryen këto detyra si në vijim:

- përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë;
- lidh kontrata në emër të Shoqërisë;
- organizon dhe udhëheq veprimtarinë e Shoqërisë;
- menaxhon pasurinë e Shoqërisë;
- zbaton vendimet e Shoqërisë;
- vendos mbi dispozicionin e mjeteve financiare të Shoqërisë;
- propozon programe dhe plane në fushat për të cilat është themeluar Shoqëria;
- përgatit propozon e planit vjetor të punës dhe planin financiar të Shoqërisë;

- përgatit raportin vjetor mbi realizimin e programit vjetor të punës së Shoqërisë si dhe dëshminë financiare;
- vendos mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në pajtim me ligjin;
- kryen dhe detyra të tjera lidhur me punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë, në pajtim me ligjin, me Vendimin mbi themelimin dhe me Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria është e obliguar që ta informojë vazhdimisht Themeluesin dhe subjektet tjera që shprehin interes ligjor për përcjelljen e punës dhe funksionimin e saj.

III KAPACITETET E USHTUESIT TË VEPRIMTARISË KOMUNALE

III/1 Resurset njerëzore

Në periudhën raportuese, Shoqëria kishte të angazhuar gjithsej 39 të punësuar për të kryer detyra nga veprimtaria e saj.

III/2 Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale

Me qëllim të zbatimit të veprimtarisë komunale të Ushtruesit, veprimtarinë komunale, për të cilën është themeluar, ka kryer në objektet që vijojnë:

Objektet	Adresa
1. Tregu i gjelbër	Tuz p.n.
2. Tregu i mallrave të përzier	Tuz p.n.

Tregu i mallrave të përziara disponon 426 hapësira shitjeje, me një sipërfaqe totale prej 5278 m².

Tregu i gjelbër ka në dispozicion 22 tezga për shitjen e frutave dhe perimeve, një sektor për djathë dhe mish, 6 hapësira shitjeje për peshk dhe 6 hapësira shitjeje për lule. Në kuadër të Tregut të gjelbër ekziston edhe një hapësirë afariste që jepet me qira nga Shoqëria.

III/3 Pajisjet dhe parku i makinave

Shoqëria e ka kryer veprimtarinë e besuar me pajisjet ekzistuese, të përcaktuara në listën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësinë e saj. Shoqëria nuk posedon automjet zyrtar.

IV BAZAT PËR PËRPUNIMIN E RAPORTIT

Përgatitja e këtij Raporti bazohet në Rregulloren mbi përmbajtjen e detajuar të Programit Vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor mbi realizimin e programit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 54/20), si dhe në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara.

V RAPORTI MBI REALIZIMIN E AKIVITETIT FIZIK

Siç dihet, Shoqëria administron dy objekte tregu – tregun e përzier dhe tregun e gjelbër në Tuz.

Tregu i përzier në Tuz ka në dispozicion 426 hapësira shitjeje.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është shfrytëzuar mbi 90% e kapacitetit të këtij objekti tregu.

Nga tregu i përzier në vitin 2025 janë realizuar gjithsej të ardhura në shumën 511.063,50 euro.

Në bazë të arkëtimeve ditore janë realizuar 72.048,50 euro, ndërsa në bazë të kontratave të qirasë janë realizuar 439.582,00euro.

Tregu i gjelbër ka 22 tezga për shitjen e frutave dhe perimeve, një sektor për djathë dhe mish, 6 vende shitjeje për peshk si dhe 6 vende shitjeje për lule.

Në kuadër të Tregut të gjelbër ekziston edhe një hapësirë afariste që jepet me qira nga Shoqëria.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është shfrytëzuar mbi 95% e kapacitetit të këtij objekti tregu.

Nga Tregu i gjelbër në vitin 2025 janë realizuar gjithsej të ardhura në shumën 14.732,50 euro. Të gjitha të ardhurat në Tregun e gjelbër janë realizuar në bazë të kontratave të qirasë. Nuk ka pasur të ardhura nga arkëtimet ditore në këtë objekt tregu.

VI REALIZIMI I PLANIT FINANCIAR

SH.P.K. "Pijace/Tregu" Tuz gjatë periudhës raportuese nga 01 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025 ka realizuar një rezultat financiar, të cilin në këtë pjesë do ta paraqesim në formë tabelare me një pasqyrë krahasuese të të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara.

VII TREGUESIT FINANCIARË TË REALIZUAR

Në pjesën në vijim paraqitet pasqyra tabelare e planit financiar për vitin 2025 me arsyetimin përkatës, përkatësisht strukturën e tyre.

VII/1 Të ardhurat e realizuara për vitin 2025

	TË ARDHURAT		
61	1. TË ARDHURAT NGA SHITJA E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE NË TREGUN E BRENDSHËM	PLANI 2025	REALIZIMI
6122	Të ardhurat nga shërbimet për personat fizikë dhe juridikë në vend	583.156,00	526.363,00
	NË TOTAL 1	583.156,00	526.363,00
64	1. TË ARDHURAT NGA PREMITE, SUBVENCIONET, DOTACIONET, DONACIONET ETJ.		
6403	Të ardhurat nga donacionet (transferet nga buxheti I Komunës)	100.00,00	100.520,00
	NË TOTAL 2:	100.00,00	100.520,00
65	3. TË ARDHURAT TË TJERA NGA VEPRIMTARIA	8.290,00	2.657,46
659		8.290,00	2.657,46
	TË ARDHURAT TOTALE	691.446,00	629.540,46

VII/2 Shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2025

	Paraqitja analitike	PLANI 2025	PLANI I REALIZUAR
	SHPENZIMET		
27	I TAKSA MBI VLERËN E SHTUAR	80.000,00	77.697,23
	Detyrimet mbi TVSH-në	80.000,00	77.697,23

Shpenzimet materiale

51	II SHPENZIMET MATERIALE	41.000,00	38.703,48
5120	Shpenzimet e materialeve për mirëmbajtjen e higjienës	1.000,00	347,29
5121	Shpenzimet e materialeve të zyrës	2.000,00	562,60
5124	Shpenzimet e materialeve të tjerë	2.000,00	1.218,09
5130	Shpenzimet e energjisë elektrike	36.000,00	36.575,50

Shpenzimet e pagave, kompensimi i pagave dhe shpenzimet e tjera personale

52	III SHPENZIMET E PAGAVE, KOMPENSIMI I PAGAVE DHE SHPENZIMET E TJERA PERSONALE	465.462,00	457.845,89
5200	Kostot neto të pagave për punë të rregullt	372.000,00	369.556,48
5207	Shpenzimet e taksave mbi pagën dhe shtesat e pagave që përballohen nga punonjësi	17.620,00	16.844,61
5208	Shpenzimet e kontributeve të pagave dhe shtesave të pagave që përballohen nga punonjësi	46.281,00	45.246,95
5210	Shpenzimet e taksave mbi pagën dhe shtesat e pagave që përballohen nga punëdhënësi	4.334,00	3.319,08
5211	Shpenzimet e kontributeve të pagave dhe shtesat e pagave që përballohen nga punëdhënësi	5.627,00	5.528,77
522	Kostot e kompensimit sipas kontratës mbi vepër	10.000,00	7.750,00
526	Pagesa për anëtarët e Bordit të drejtorëve	9.600,00	9.600,00

Kostot e shërbimeve të prodhimit

53	V KOSTOT E SHËRBIMEVE TË PRODHIMIT	72.780,00	56.606,24
5312	Shërbime të komunikimit	5.180,00	3.200,81
5334	Kostot e qirasë së objektit afaristë	36.000,00	34.164,00
539	Kostot e shërbimeve të tjera	31.600,00	19.241,43

Shpenzimet jomateriale

55	VI SHPENZIMET JOMATERIALE	27.204,00	26.718,23
5501	Kostot për shërbimet e avokatit	2.904,00	3.049,20
5509	Kostot e shërbimeve të tjera joprodhuese	21.500,00	21.249,21
5510	Kostot e përfaqësimit, shtypit dhe bifesë	1.500,00	1.386,34
5524	Kostot e sigurimit të punonjësve gjatë punës	500,00	482,11
5530	Shërbimet bankare / provizjonet	800,00	551,37

SHPENZIMET TË TJERA

57	VI SHPENZIMET TË TJERA	5.000,00	3.289,95
57942	Shpenzimet për blerjen e pajisjeve dhe veshjeve për të punësuarit	500,00	0,00
57943	Shpenzimet për blerjen e kompjuterëve dhe printerëve	1.000,00	155,00
57946	Shpenzimet për blerjen e pajisjeve për zyra dhe objekte të tregut	2.500,00	2.608,73
	Shpenzimet për blerjen e mobiljeve të zyrës	1.000,00	526,22

PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2025

VII PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2025	2025	REALIZIMI
TË ARDHURAT TOTALE TË PLANIFIKUARA	691.446,00	629.540,46
SHPENZIMET TOTALE TË PLANIFIKUARA	691.446,00	660.861,02
FITIMI / HUMBJA	0,00	-31.320,56

BURIMET FINANCIARE

Burimet financiare:	PLANI 2025	REALIZIMI
BURIMI I TË ARDHURAVE	SHUMA	SHUMA
Mjetet nga buxheti i Komunës	100.000,00	100.520,00
Të ardhurat e planifikuara nga burimet vetanake	583.156,00	526.363,00
Të ardhurat të tjera nga veprimtaria	8.290,00	2.657,46
GJITHSEJIT:	691.446,00	529.540,46

VII/3 Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025

Me realizimin e kryerjes së aktiviteteve komunale për vitin 2025, Shoqëria ka operuar me rezultat me humbje 31.320,56 euro

Shoqëria ka realizuar të hyra në shumën totale prej **629.540,46 €**.

Në pozicionin me numrin rendor 1, grupi i llogarive 61 - të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve të regjistruara në bërthmën e shumës prej **526.363,00 €** përbëjnë:

Ofirimi i shërbimeve në tregun e mallrave të përzier / në bazë të pagesës ditore;

- të ardhurat e realizuara në shumën prej **72.048,50 €**

Të ardhurat nga tregu i mallrave të përzier në bazë të kontratave;

- të ardhurat e realizuara në shumën prej **439.582,00, €**

Të ardhurat në tregun e gjelbër në bazë të kontratave;

- të ardhurat e realizuara në shumën prej **14,732.50 €**

Në pozicionin me numër rendor 2, grupi i llogarisë 64, të ardhura nga primet, subvencionet, dotacionet, donacionet etj. në vlerë prej **100.520,00 €**, përbëhen nga:

- të ardhura nga donacionet (transferta nga buxheti i Themeluesit, Komuna e Tuzit) 100.000,00 €
- donacioni nga Camaj Vaselj me Shumen **520,00 €**

Në pozicionin me numër rendor 3, grupi i llogarisë 64, të ardhurat të tjera operative në vlerë prej od **2.657,46 €**,

Me programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2025, Shoqëria ka arritur shpenzime totale në vlerë prej **660.861,02 €**

Llogaria e grupit 27, taksa mbi vlerën e shtuar, në shumën prej **77,697.23 €**.

Llogaria e grupit 51 në shumën prej **38,703.48 €** përbëjnë:

- shpenzimet e materialeve për mirëmbajtjen e higjienës **347,29 €**
- shpenzimet e materialeve të zyrës **562,60 €**
- shpenzimet e materialeve të tjerë **1.218,09 €**
- shpenzimet e energjisë elektrike **36.575,50 €**

Llogaria e grupit 52 përbëjnë shpenzimet e rrogave bruto për të punësuarit si dhe kompensimet për anëtarët e Bordit të drejtorëve në shumën prej **457.845,89 €**.

Struktura e këtyre shpenzimeve është e detajuar në planin financiar. Shpenzimet nga ky grup janë realizuar në bazë të numrit të veprimeve që janë të nevojshme për qëndrueshmërinë dhe procesin e punës së kësaj ndërmarrje.

Llogaria e grupit 53, kostot e shërbimeve të prodhimit në shumën totale prej **56.606,24 €** përbëjnë:

- shërbime të komunikimit **3.200,81 €**
(mirëmbajtja e arkës fiskale **221,43 €**
(rrjeti i telefonisë celulare **2.979,38 €**
- shpenzimet për qirat të objekteve që shfrytëzon Shoqëria në vlerë prej **34.164,00 €**:
(qira për objektin e Tregut të gjelbër **24.000,00 €**)
(qira për zyrat e Shoqërisë **10.164,00 €**)
- të tjerat shërbime **19.241,43 €**, prej të cilëve:
- katalogu i rregulloreve **499,68 €**
- kostot e shërbimeve të dezinfektimit, deratizimit etj. **2.867,00 €**
- shpenzimet e sponzorimit në vlerë prej **10.400,00 €**
- të shpenzimet për shërbime të tjera **5.474,75 €**

Llogaria e grupit 55, shpenzimet jomateriale në shumën totale prej **26.718,23 €** përbëjnë:

Shpenzimet për shërbimet e avokatit **3.049,20 €**

Kostot e shërbimeve të tjera joprodhuese **21.249,21 €**, prej të cilëve:

- shpenzimet e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së softuerit **2.904,00 €**
- shpenzimet për shërbime komunale **18.345,21 €**
(heqja e mbetjeve komunale **16.885,20 €**)
(shpenzimet për ujë **1.460,01 €**)
- kostot e përfaqësimit, shtypit ditor dhe bifesë **1.386,34 €**
(kapsula kafeje **797,69 €**)
(shpenzimet e përfaqësimit dhe bifesë **588,65 €**)
(kostot e sigurimit të punonjësve gjatë punës **482,11 €**)
- shpenzimet bankare / provizionet **551,37 €**.

Llogaria e grupit 57 përbëjnë shpenzimet e tjera në shumën prej **3.289,95 €**.

- Shpenzimet për blerjen e pajisjeve dhe veshjeve për të punësuarit në shumën prej **0,00 €**
- Shpenzimet për blerjen e kompjuterëve dhe printerëve në shumën prej **155,00 €**
- Shpenzimet për blerjen e pajisjeve për zyra dhe objekte ndihmëse në shumën prej **2.608,73 €**

Shpenzimet për blerjen e mobiljeve të zyrës në shumën prej **526.22 €**

VIII POLITIKA E RROGAVE DHE PUNËSIMIT

Tabelat 1, 2 dhe 3 të cilat vijojnë në tekstin e Programit, përcaktohen si përmbajtje e detyrueshme të Programit, në përputhje me pikën 10 të shtesës 1 të Rregullores (politika e pagave dhe punësimit) mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale.

***Tabela 1. Struktura e punonjësve sipas formimit profesional,
d.m.th. nivelit e kualifikimit të arsimit***

LLOJI I PUNËS	niveli VI, VII ose më shumë	niveli IV	niveli III	niveli II ose I2	PK
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	3				
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE		2			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	1				
PUNËT JURIDIKE	2				
VEPRIMTARIA THEMELORE		11	1	1	
MIRËEMBAJTJA				5	3
PUNËT LOGJISTIKE				5	3
GJITHSEJ – 39	6	14	4	12	3

Vërejte*: Punët logjistike janë vendet e punës: roje, sigurim, shofer-kurir dhe portier.

Tabela 2. Struktura e punonjësve sipas moshës

LLOJI I PUNËS	18-25	26-35	36-45	46-55	56-65	Mbi 65
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT		2			1	
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE		1	1			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT				1		
PUNËT JURIDIKE		1	1			
VEPRIMTARIA THEMELORE	1	7	2	1	2	
MIRËMBAJTJA		1	2	4	1	
PUNËT LOGJISTIKE	1		2	6	1	
GJITHSEJ - 39	2	12	8	12	5	0

Tabela 3. Struktura e punonjësve sipas viteve të shërbimit

LLOJI I PUNËS	Deri në 5 vite	6 - 10	11 - 15	16 - 25	26 – 35	Mbi 35
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	1	1		1		
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE	1		1			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	1					
PUNËT JURIDIKE	2					
VEPRIMTARIA THEMELORE	7	3	2	1		
MIRËMBAJTJA	4	1	1	1	1	
PUNËT LOGJISTIKE	8	1			1	
GJITHSEJ - 39	24	6	4	3	2	0

IX BORXHI

Shoqëria gjatë vitit 2025 nuk ka pasur asnjë detyrim kreditore.

X REALIZIMI I PLANIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Sistemi i ri elektronik i prokurimeve publike (SEPP) mundëson transparencë më të madhe të prokurimeve publike, disponueshmëri më të madhe të informacionit për procedurat e zbatuara të

prokurimit publik të gjithë autoriteteve kontraktuese, e rrjedhimisht edhe për SHPK "Pijace/Tregu" Tuz.

Plani i prokurimit publik i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz për vitin 2025, është miratuar më 15 janar 2025. Plani është ndryshuar dhe plotësuar 1 (një) herë.

Të gjitha procedurat janë kryer brenda afatit të përcaktuar me ligj, pa ankesa dhe kundërshtime nga ofertuesit dhe në përputhje me Rregulloren e vlefshme për mënyrën e kryerjes së prokurimit të thjeshtë ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 16/23, 20/23, 36/23).

X POLITIKA E ÇMIMEVE

Gjatë vitit raportues është zbatuar Çmimorja e shërbimeve të Shoqërisë e cila është miratuar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë nr. 1102/23 prej më 18.12.2023, për të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit ka dhënë pëlqimin nr. 02-016/23-8550/1 prej më 28.12.2023 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 03/24 prej më 11.01.2024).

Përveç çmimores në fuqi, është miratuar Vendimi i Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë nr. 719/25 i datës 12.09.2025 për plotësimin e çmimores, për të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit ka dhënë pëlqimin me Vendimin nr. 02-016/25-7092/1 të datës 29.09.2025.

Plotësimi i çmimores është bërë për shkak të nevojës për të përcaktuar më saktë çmimet e përdorimit të tezgave të pazarit për shitjen e djathit dhe vezëve, pasi këto kategori nuk ishin të përfshira veçmas në çmimoren aktuale

XI VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Në periudhën në vijim, me ndihmën e Themeluesit dhe angazhimin të stafit tonë, do të punojmë për përmirësimin e kushteve për përdoruesit e shërbimeve tona, si dhe për promovimin e funksionimit efikas të Shoqërisë.

Shoqëria ka vazhduar aktivitetet për përshtatjen e dokumenteve normativë me legjislacionin në fuqi, duke përmirësuar kështu kornizën ligjore të veprimtarisë. Pjesa më e madhe e fokusit është vendosur në ruajtjen e likuiditetit dhe solventës, si dhe në mbledhjen më efikase të shërbimeve, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e mëtejshëm të Shoqërisë.

Është arritur një bashkëpunim i suksesshëm me Komunën e Tuzit, Kuvendin e Komunës dhe organet përkatëse, çka ka mundësuar realizimin më efikas të qellimeve programore.

Në fund, duhet theksuar se Shoqëria do të marrë masat e nevojshme në aktivitetet e ardhshme, të cilat do të rezultojnë në përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së këtij subjekti.

Numër: _____/26-1
Në Tuz, më 19.02.2026

U.d. i drejtorit ekzekutiv
Ruzhdi Lluka

Dorëzuar:

- Shërbimit të Kryetarit të Komunës
- Sekretariatit për zhvillim dhe projekte
- Arkivit të Bordit të drejtorëve
- a/a